



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 64

Prishtinë, më 30.12.2016, në orën 20:00

Ndërtesa e Kuvendit, N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Bislim Zogaj, Fatmir Xhelili, Vjosa Osmani, Arben Gashi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Valdete Bajrami, Slobodan Petroviq, Xhavit Haliti, Donika Kadaj - Bujupi dhe Time Kadrijaj.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi Njomza Emini , kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja e Komisionit, ka lexuar opinionin ligjor për harmonizimin dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe konstatoj se ky Projektligj nuk është i rregulluar me Acquis të BE-së.

Prandaj, kryetarja konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së. Kurse amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional gjithashtu nuk janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, përkatësisht të Acquis.

Mbledhja përfundoi në orën 20:15.

E përgatiti

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini